



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:216564

Datë: 24.11.2022

Numri i dokumentit: 03686956

**P.nr.991/2022**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN** Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpunatoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, ne çështjen penale kundër të pandehurit D. A. nga Gjilani, për shkak të veprës penale:posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr...../2022 të datës 17.10.2022, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 09.11.2022, mori dhe publikisht shpalli ndërsa më dt.24.11.2022, hartoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri D. A., nga babai G. dhe nëna A....., e gjinisë B., i lindur me datë ....., me vendbanim në Gjilan,rr."I. P.", nr..., me numer personal....., ka të kryer shkollën e mesme, beqar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse me datën 09.09.2022, rreth ores 21:40, në Gjilan,rruga "Mërgimtarët e Gjilanit", Njësia Patrolluese, për kontrollë ka ndalur veturën e markës "Mercedes",ngjyrë e zezë,me tabela ..-....-SB, të cilën e drejtonte i pandehri dhe gjatë kontrollimit në veturë, policia ka gjetur një qese substance narkotike, e që sipas testit fushor substance narkotike ka rezultuar të jetë e llojit "Marihuanë", me peshë 3.9gram,e cila sasi sekuestrohet nga ana e policisë,me çka i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit "Marihuanë".

**-Me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve,substancave psikotrope ose analoge,nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-ës.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës, të pandehurin D. A.:

**E G J Y K O N**

I.Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditëve**, ashtu që me propozimin dhe me pëlqimin e të akuzuarit dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, të akuzuarit D. A., dënimi i shqiptuar me burgim i **ZËVENDËSOHET**, me dënim me gjobë në shumën prej **400 (katërqindë)€**, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej **200 (dyqindë euro)€**, të cilën gjobë i njejtë është i obliguar ti paguajë në afat prej **15(pesmbëdhjetë) ditëve**, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri i lartcekur, nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë.

Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-ës nga i pandehuri **KONFISKOHET** substanca narkotike e llojit "Marihuanë", me peshë 3.9 gram e cila pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet të përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t'ia bashkëngjisin lëndës përkatëse.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë- euro)€, si dhe shumën prej 30 (tridhjetë euro) €, për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 20.10.2022, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr...../2022, kundër të pandehurit D. A. nga Gjiilani, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me datë 13.07.2022, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezente prokurorja e shtetit, Huma Jetishi, dhe i pandehuri D. A., me ç'rast pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri i lartcekur, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njejtë deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

### 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër 2022-DHTN-....., i datës 09.09.2022, deklarata e të pandehurit D. A., raporti njoftues për test fushor, kërksë për ekzaminimin e substancës narkotike, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, foto dokumentacioni, të dhënat nga data-baza e

policisë për të pandehurin, raporti i zyrtarit policor, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### **Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri D. A., e ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-ës, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqindë-euro)€, dhe dënim me gjobë në shumë, prej 200 (dyqindë-euro)€, të cilën gjobë është obliguar ta paguajë nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71, dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale të cilën i vihen në barrë në një fazë të hershme të procedurës, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori për bazë shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, e cila vepër penale është në rritje tek të rinjtë tanë, dashjen e të pandehurit për ta kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor siq shihet në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69, 70 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që për të akuzuarin si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ka shprehur keqardhje dhe se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej këtë vepër apo vepër tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata e mori për bazë shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, e cila vepër penale është në rritje tek të rinjtë tanë.

### **Konfiskimi**

Duke u bazuar në nenin 269 paragrafi 3 të KPRK lidhur me nenin 115 të KPP-ës, gjykata ka vendosur që t'ia konfiskoje substancën narkotike të llojit "Marihuanë", në sasi prej 3.9gr.

### **Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Sipas bindjes së gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur, duke i marr parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë të pandehurit. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### **8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.991/2022, me datë 24.11.2022

Gjyqtarja e vetëme gjykuese,  
Mevlide Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.